

Redaksisë së nderuar "Bota sot"!

Duke qenë në pamundësi të komunikoj drejtpërdrejtë me gazetën e nderuar "The Washington Post", Ju lutem të shtypni këtë reagim timin në lidhje me artikullin z. Nicolas Gage-it të dt. 22 maj 2001.

Parapakiht Ju falemnderit.

-----

Të nderuar lexuesë dhe e nderuara Redaksi "The Washington Post"-it!

Në faqet e gazetës së Suaj të nderuar, më 22 maj 2001, u paraqit z. Nicolas Gage me një artikull nën titull: "Para gjakderdhjes së re ballkanike". Do të ishte në rregull si çdo artikull tjetër po të mos gëlonte në tërësi me dezinformata dhe të pavërteta shokante.

Latinët e lashtë e kanë një fjalë të urtë: "Timeo Danaos et dona ferentia!" (Ruaju Danajasve (grekëve) edhe atëherë kur të ofrojnë dhuratat), që e denoncon karakterin mashtrues dhe dhelparak grek.

Zotëri Nicolas Gage, me artikullin e vet, e vërtetoi sentencën largpamëse të Latinëve të lashtë, duke e shkruar artikullin në fjalë i shtyer nga motivet qëllimkeqe, ndjellakeqe, tendencioze, plot insinuata dhe urrejttje patologjike ndaj kombit dhe shtetit ilir-shqiptar.

Me këtë artikull z. Gage dëshmoi se në edukatën e tij nuk kanë ndikuar aspak vlerat morale e etike të shoqërisë demokratike e qytetëruese të Shteteve Bashkuara Amerikane; nuk është frymëzuar me filozofinë e dashurisë, mëshirës e përdëllimit të Shëlbyesit Krisht, por me filozofinë sataniane të fëmës së institucioneve kishtare greko-sllave të urrejtjes, smirës dhe lakmisë si tharë të hakmarrjes dhe vese e cene të trashguara të shëmtisë si produkte GJENOTIPIKË dhe si "akt natyror" dhe "akt i Zotit"; nuk mund të emancipohet dhe të shkëputet nga edukata biznatinio-sllave për inskenime të ngjarjeve dhe kompleteve.

Te z. Gage vërehet heptas se ka mbisubduar shprehja dhe zënë rrënjë të thellë MORAL INSANITY (mungesa e arsyes etike dhe mungesa e ndjenjës elementare njerëzore, një lloj i çmendurisë me prirje kundërshoqërore) nga verbëria e urrejtjes patologjike të kombit dhe të shtetit shqiptar, sikurse edhe nga kompleksi i vlerës së lartë të kombit "superior" grek

i "zgjedhur nga vetë Zoti" për të sunduar Ballkanin dhe tërë botën. Me kësajsoj bindjesh, z. Gage, e ka humbur arsyen e njeriut normal duke u kredhur në zonën e errësirës së çmendurisë ksenofobe, e postafat të asaj albanofobe. Për z. Gage, bota fillon dhe mbaron me Greqinë dhe është i gatshëm ta flijojë tërë botën për Greqinë. Absurditeti i preokupimeve të tija e ka vetëm një shpjegim - EGOCENTRIZEM ABSOLUT.

Jam thellë i zhgënjyer dhe i dëshpruar me "inteligjencën", "erudicionin" dhe "elokuencën brilante" të publicistit "zulmadh", z. Gage. Kam pas formuar një bindje dhe mendim se z. Gage, me shkrimet e tija, është në nivel të duhur me shijen, kërkesat, diturinë dhe interesimin e lexuesve të nderuarë të "The Washington Post"-it. Mjerisht, po e shoh se paskam qenë në lajthitje dhe i mashtruar me aftësitë e tija, duke qenë se doli në shesh cektësia e arsimit të tij, mungesa e kulturës së gjerë, dituria e kufizuar, obskurantizmi mesjetar, tërbimi vullgar dhe primitivizmi atavist. Është tejet e tejdukshëm me qëllimet e veta tendencioze kundërshqiptare, njëkohësisht edhe kundër interesave të Shteteve Bashkuara Amerikane, duke i sugjeruar të ndërmarrin aksione të tilla joparimore, jodemokratike dhe kundërnjerëzore që aspak nuk përkojnë me frymën lirisdashëse, humane dhe kozmopolite; me frymën e të vërtetës, të drejtësisë dhe të drejtshmërisë të popullit dhe të shtetit të Shteteve Bashkuara Amerikane.

Zotëri Gage na doli një publicist provincial, me njohuri të kufizuar dhe PA PATRIOTIZËM ABSOLUT ndaj ShBA-ve, duke qenë se artikulli i tij është, fund e krye, i thurur me të pavërteta, rrena, gënjeshtër, trillime dhe mashtrime për t'i dezinformuar lexuesit e nderuarë të "The Washington Post"-it dhe opinionin e gjerë të ShBA-ve. Q'është edhe më e keqja, z. Gage, mëton të ndikojë në sajimin, në përpilimin, në hartimin dhe në zbatimin e politikës së ~~ShBA~~ State Departementit, Kongresit, Senatit, të Penatagonit dhe të Presidentit të Shteteve të Bashkuara Amerikane që të orientohet kryekëput kundër DY MILIONË shqiptarëve fatzinj kosovarë të cilët, deri në emshim, janë dhe do të jenë mirënjohës popullit dhe shtetit të ShBA-ve për kontributin e dhënë për shpëtimin e

tyre (shqiptarëve të Kosovës) nga holokausti dhe shfarosja bilogjike nga fiset amok, homicidoman dhe thanstoman bizantino-sllav, grek dhe serb.

Ndër të tjera, z. Gage, thotë: "Me serbët e "thyer" dhe Sllobodan Millosheviqin nën arrest, kërcënimi më i fuqishëm për stabilitetin në rajon është nacionalizmi shqiptar".

Me këtë mendim të tij tendencioz mëton t'i mobilizojë të gjithë institucionet dhe opinionin e ShBA-ve që të koncentrohen vetëm e vetëm kundër "nacionalizmit" shqiptar si më i "rrezikshmi" në rajon dhe si "rrezik potencial" duke qenë se nacionalizmat tjerë në Evropën Juglindore nuk ekzistueskan, si për shembull ai grek, serb, malazias, sllavomacedonas, bullgar, kroat, rumun etj. Është aq i pëcíp, mendjemasdh dhe i pëskrupull sa që mundohet, me tërë potencialin e tij intelektual të mjerë, ta fshehtë realitetin dhe rrezikun potencial dhe permanent nga nacionalizmi dhe racizmi bizantino-pansllavist. Është një realitet i pakontestueshëm se rreziku më i madh dhe i vetmi, për Evropën dhe Botën, ka qenë, është dhe për një kohë të gjatë do të jetë naci-racizmi bizantino-pansllavist me ushtrinë e tyre numerikisht më të madhe në botë dhe me një arsenal bërthamor për ta shkatërruar rruzullin tokësor qindra herë.

Zotëri Gage vetë e cekë se: "Ndërkohë që Shqipëria vetë është shumë e dobët ushtarakisht për të promovuar synim rajonal për "Shqipërinë e Madhe", që absolutisht pajtohem, sepse armiqët e përbetuar të shqiptarëve dhe të Shqipërisë si z. Gage, Llobi grek në ShBA-të dhe ndihma e parazervë të shteteve bizantino-sllave: Rusisë, Serbisë e sidomos Greqisë dhe të shpirtshiturëve shqipfolës nga brenda, ia dolën ta DEFAKTORIZOJNIE Shqipërinë e mjerë në arenën ndërkombëtare duke e shkatërruar dhe shkretuar fuqinë e saj (Shqipërisë) ekonomike, ushtarake, politike e diplomatike për më se pesëdhjetë vite të ardhshme kështu që "rrezik" për rajonin po paraqitet Kosova, siç edhe e cekë z. Gage: "Ekzistojnë mjaft armë dhe mjaftë nacionalistë në enklavat shqiptare të ish-Jugosllavisë, për ta ndezur një konflikt në zonë, që mund të jetë edhe më shkatërruese se ÇFARDO konflikti që kemi parë DERI MË TANI".

Zotëri Gage amerikan do ta tradhtonte Gage-in GREK po të mos manipulonte me dezinformata Goebbelsiane dhe kominformbiroiste, duke shtrembëruar të vërtetën dhe realitetin në stilin e shkollës së errët mesjetare të temjanit kutërbonjës të institucioneve kishtare bizantino-sllave. Tre milionë shqiptarë të "enklavave të ish-Jugosllavisë", siç thotë z. Gage, pa ushtri e polici, pa industri ushtarake, me ekonomi totalisht të shkatërruar nga ana e vëllezërve serbë të z. Gage-it vandal e barbarë; Kosova me popull të masakruar e të traumatizuar, nën protektoratin e UNMIK-ut të OSBE-së dhe nën mbikëqyrjen dhe sundimin e forcave të KFOR-it, qenkan rrezik për zonën?

A është e mundur që një mendim i tillë i çoroditur, i pabazë, i paargumentuar, i trilluar dhe i instrumentalozuar në stilin e vëllait të tij serb, Dobrica Qosiqit (akademik dhe skrimtar serb) se: "Gënjeshtër për serbin (në këtë rast edhe për grekun-R.B.) është detyrë patriotike, formë e patriotizmit dhe dëshmi e inteligjencës serbe (greke-R.B.) natyrore. Serbët (grekët-R.B.) gënjejnë në mënyrë krijuese, fantastike, inventive dhe bindëse", të gjegjë përkrahjen dhe aprovimin e institucioneve dhe të opinionit të ShBA-ve? A është e mundur që z. Gage aq shumë ta nënçmojë dhe përbuzë intelektin e qytetarëve amerikan, duke u serviruar këtë rreth dhe dezinformata? Zotëri Gage mundohet, pa kurrfarë ndërgjegje, të manipulojë me ndjenjat fisnike të popullatës krishterë të ShBA-ve për solidarizim, mëshirë e përdëllim me sivëllezër krishterë "pakicë" në Shqipëri kur thotë: "Çelësi i suksesit i një konference të tillë (ndërkombëtare për Ballkanin Jugor për t'u marrë me shkakun kryesor të konfliktit në rajon: trajtimin e minoriteteve) është bazimi i saj në parimet se të drejtat e njëjta duhet të ndahen nga të gjithë minoritetet në rajon - minoritetet KRISHTERË në Shqipëri si dhe minoritetet shqiptarë në ish-Jugosllavi".

Zotëri Gage i bënë dy gabime të pafalshme për një publicist ku:

1. Krishterët në Shqipëri, popullatën krishterë shqiptare ortodoks dhe katolik, i shndërron në minoritet dhe
2. Greqinë shumëkombëshe e përjashton si shtet me minoritete duke e

rreshtuar në shtete monokombëtare dhe monofetare, pa kombe dhe besime të tjera në Greqinë e tij të dashur. Sa për ilustrim do ta përmend vetëm minoritetin rreth dy milionë shqiptarëve (arvanitasë, siç na quajnë grekët), pa kurrfarë të drejtash elementare njerëzore e këre më atë kombëtare dhe të cilët (arvanitasë) nuk guxojnë as në shtëpi të flasin gjyhen e tyre amëtare (shqipe), megjithëse kanë kontribuar me armë në dorë në krijimin e shtetit të sotëm grek.

Sipas mendjes së tij DEFECTUS KAPITOLLI (defektit në kokë) të mjerë, nacionalizmi i tre milionë shqiptarëve në "enklavat e ish-Jugosllavisë" do të ishte edhe "më shkatërruese se çfarëdo konflikti që kemi parë deri më tani", që do të thotë edhe më trishtuese dhe më fatale sesa konflikti dhe holokausti i 6 milionë hebrenjëve gjatë Luftës së Dytë Botërore të shkaktuara nga nazizmi gjerman! Vetëm imagjinata fantazmagorike e trurit të mykosur të Nicolas Gage-it mund të trillojë një mendim të tillë që barazohet me imagjinatën e të një njeriu të zonës së errësirës pa kufi dhe pa kurrfarë dimensione.

Frika paranoike e z. Gage-it del në shesh kur thotë se: "Konflikti, që tani e shohim në Maqedoni, do të përhapet në jug dhe do të arrijë kufijtë e Greqisë". Këtu edhe po qëndruaka kleçka! I gjori, z.Gage! Po trishtoheshka nga frika dhe tmerrri i vetë të mendimit se tre milionë shqiptarë në "enklava të ish-Jugosllavisë", me ushtri të çarmatosur (UÇK-ja e çarmatosur nga KFOR-i), të uritur dhe pa veshmbathje, do ta rrezikojnë Greqinë 10 milionëshe me një armatë bashkëkohore, anëtare e NATO-së dhe anëtare e Unionit Evropian!? Vetëm ta mendosh një mundësi të tillë është AD ABSURDUM e lëre më ta shkruash e ta kumtosh publikisht në shtyp, siç bëri z. Gage, dhe atë në Shtetet e Bashkuara Amerikane! Thonë se frika është më e tmerrshme sesa edhe vetë vdekja. Këtë frikë paranoike të z. Gage-it e demanton vetë Ministria e Jashtme greke dhe zëdhënësi i shtetit grek, z. Dhimitris Repas: "Greqia ka hedhur poshtë të hënën pohimet e kryterait të Jugosllavisë, Vojislav Koshtunica, se kryengritësit shqiptarë etnikë, të cilët kanë qenë aktiv në Kosovë dhe në Maqedoni, janë vendosur edhe në Greqinë Veriore. Nuk ka kurrfarë zhvillimi të tillë

politik", (Athinë 18 qershor 2001 "Reuters) dhe shtohet: "Zyrtarët e Ministrisë së Jashtme greke kanë thënë ndërkaq se janë SHKANGUR me këtë deklaratë të Koshtunicës". Ja z. Gage, populli ynë shqiptar thotë: "Arena i ka këmbët e shkurta". Para disa javësh, propaganda e shfrenuar kundërshqiptare, e lansoi në eter rrenën nëpërmjet të një radiostacioni enigmatik austrian, se në Greqinë Veriore janë formuar aradhat e Ushtrisë Çlirimtare Çame. Tur e vrap këtë renë e transmetuan edhe radiostacionet e shteteve sllave, për të alarmuar botën nga "invazioni i ushtrisë shqiptare", të "enklavave shqiptare të ish-Jugosllavisë".

Populli i Shteteve të Bashkuara Amerikane, me të vërtetë, është besnik, fisnik, zemërgjerë e shpirtmadh, por s'është aq naiv e të bie në grackën e të një naci-racistit të ideologjisë komuniste-pansllaviste, siç është z. Nicolas Gage!

Mbase, z. Gage, do t'ia del ta mashtrojë një pjesë të vogël të popullatës së painformuar të ShBA-ve me analizën e tij "reale" dhe "objektive" për zgjidhjen e problematikës së rajonit, duke u mbështetur në dinakrinë inventive, finoke dhe të rafinuar të vetive të karakterit labil e paranoik të një grekut të frymëzuar në frymën e shkollës bizantino-pansllaviste, por nuk mund të manipulojë edhe me masën e gjerë të popullatës dhe të institucioneve të ShBA-ve, sepse janë shumë mirë të informuar me realitetin faktik e të mirëfilltë në Shqipëri. Në Shqipëri nuk kanë ekzistuar dhe nuk ekzistojnë "minoritetet krishtere", siç thotë z. Gage, duke qenë se vetë shqiptarët, një pjesë e madhe, kanë qenë, janë dhe do të jenë krishterë: ortodoks dhe katolikë. Zotëri Gage nuk është i vetëdijshëm se sa është qesharak, moralmjerrë dhe obskurant duke e keqpërdorur fenë si instrument politik në mileniumin e tretë pas Krishtit me tendencë të ringjalljes së Luftërave Kryqëzate të shekullit të XI-XIII. Zotëri Nicolas Gage tmerrohet nga mundësia e rishqyrtimit të kufijve ekzistuese në Ballkan, padrejhtësisht të definuara, nga frika e humbjes së territoreve shqiptare të pushtuara me ndihmën e nënës Rusi.

Zotëri Gage fizikisht është në shekullin XXI, kurse shpirtërisht në atë të shekullit të IV-të të Bizantit të kompleteve dhe të erozionit

të moralit. Dihet se në Greqinë e z. Gage-it sundon teokracia e shtrirë në çdo pore të jetës së përditshmërisë shoqërisë greke, por të insistojë që edhe shtetet e qytetëruara demokratike laike të shndërrohen në shtete teokrate - është sikur ta rikthesh kohën e kompjuterëve në kohë të gurit.

Vetëm shtetet ku mbisundojnë institucionet kishtare mbi institucionet demokratike, siç është rasti me shtetet greko-sllavoortodokse, kombin e identifikojnë me fenë dhe fenë me komb, sikurse edhe shtetin me institucione kishtare dhe institucionet kishtare me shtetin. Në këto shtete teokrate autokrate, institucionet kishtare janë, në të njëjtën kohë, edhe ligjdhënëse, edhe ekzekutive dhe edhe gjyqësore.

Kur jemi te kisha dhe institucionet kishtare, pse z. Gage nuk e ka minimumin e kurajos dhe të ndershmërisë e ta përmend dhe ta thotë të vërtetën (në historinë e institucioneve kishtare pa precedens) se Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare e udhëheq një nënshtetas i Greqisë, z. Anastas Janullatos, gjeneral i Uhstrisë greke me rasë të zezë të popit, i cili lirisht predikon në kisha shqiptare (ku, sipas z. Gage, krishterët nuk paskan të drejtat e pakicave) në gjuhën greke me qëllim të caktuar për helenizimin, greqizimin e shqiptarëve ortodoksë të cilët, sipas bindjeve naci-raciste të tij e të bashkëpunëtorëve dhe të bashkëpunëtorëve të tij, se çdo ortodoks është grek, ashtu që edhe shqiptarët ortodoksë na qenkan grekë.

A kishte lejuar z. Gage dhe Kisha Autoqefale Ortodokse Greke që një pop shqiptar të predikojë në kisha greke në gjuhën shqipe ortodoksve shqiptarë të Greqisë? Vetë mendimi mbi një ide të tillë do të shkaktonte në Greqi trauma të paparapara, revolt masiv dhe trazira "planetare".

KSEENOKRACIA kishtare në Greqi, siç e kanë grekët në Shqipëri, për grekët "demokratë" do të ishte një akt i papranueshëm, i papërfytyrueshëm, i papërgjegjshëm, katastrofal dhe anekronik me mileniumin e tretë.

Vallë, ç'do të bëheshte me ShBA-të po të pranonin sugjerimin e z. Gage-it që përkatësia fetare të identifikohet me pakicën (minoritetin) kombëtare? Do të ishte fund i ekzistimit të Shteteve Bashkuara Amerikane?

Nga tërë arsehalli i sugjerimeve, propozimeve dhe mendimeve të z. Gage-

it, në artikullin e nërmondur, do të pajtohej, por me rezervë, vetëm me pjesën ku thotë: "Shtetet e Bashkuara Amerikane duhet të organizojnë konferencë për Ballkanin Jugor...". Pa dyshim propozim i qëlluar dhe aktual që kurrë nuk duhet të zbresë nga rendi i ditës të institucioneve ndërkombëtare. Mirëpo, z. Gage nuk do të ishte ai që është po të mos e dredhonte kahjen e drejtë të problematikës së pakicave në rajon duke u përqëndruar vetëm me pakica në Shqipëri dhe atë "pakice krishterë". Mjerisht, truri i tij nebulloz nuk mund të çlirohet nga errësira e tymit të temjanit kishtarë bizantino-sllave.

Normat, standardet dhe kriteret që vlejné për të gjithë shtetet e qytetëruara bashkëkohore që kanë pakice (minoritete), NUK vlejné edhe për Greqinë e z. Gage-it, sepse thjesht "në Greqi nuk ekzistojnë pakicat".

Për të qenë më bindëse "rreziku nga nacionalizmi shqiptar", u hodh në përdorim edhe sintagma "Shqipëria e Madhe" një trillim, shpijë dhe krijesë e Italisë fashiste me qëllim djallëzor të përvetësimit masës së gjerë të popullatës shqiptare si "ide e qëlluar" të aspiratave mijëvjeçare të kombit shqiptar për të integruar që, nga qarqet kundërshqiptare e sidomos bizantino-sllave, u interpretuan si gogol i rrezikshëm, si ide e ekspansionit të nacionalizmit shqiptaromadh ndaj tokave shqiptare, tashmë të copëtuara dhe të okupuara nga shtetet fqinj greko-sllave; u interpretua si kërcënim i paqës dhe i qetësisë, si "rrezik permanent dhe potencial" të destabilizimit të Ballkanit, rajonit, të Evropës bile edhe të Botës së mbarë. Sintagma në fjalë shërbeu edhe si tallje, përqeshje dhe përbuzje, si: "Shqipëria e Madhe me katër sreza", "Shqipëria lilliputane" e të ngjashme e jo vetëm si shprehje e satanizuar dhe e demonizuar, duke e instrumentalizuar dhe keqpërdorur për ta diskredituar kombin shqiptar.

Saherë që shqiptarët dalin me kërkesat e veta legjitime dhe të drejta në baze të doktrinës së demokracisë dhe të Hartës së Kombeve të Bashkuara "të drejtës për vetëvendosje", këto (kërkesa) priten në bajoneta, anatemohen, kërcënohen, alarmohet tërë bota, skandalizohen, hiperbolizohen në përmasa të pashkueshme dhe projektohen si fundi i botës, si kataklizëm.



Dy milionë shqiptarë të Kosovës të traumatizuar, të terrorizuar, të masakruar, të djegur e të plaçkitur mu nga shtetet fqinj që sot çojnë pluhur për "rrezikun" që i kanoset rajonit dhe Evropës nga Kosova?!

Deklaratat e nacionalshovinistëve dhe racistëve serbë: "Serbia është prej Karllobagut e deri në Gjevojgli", "Serbia është prej Horgoshi deri në Dragash" - nuk janë rrezik?! Nuk janë rrezik as deklaratat dhe aspiratat e nacionalshovonistëve dhe racistëve grekë: "Greqia është deri te lumi Semeni në Shqipëri", sikurse edhe deklaratat e politikanëve dhe elaborati e memorandumit i Akademisë së Shkencave Maqedonase: "Pogradeci, Liqeni i Ohrid dhe ai i Prespës janë Maqedonase", nuk janë rrezik?!

Të njëjtën frikë paranoike dhe patologjike nga "rreziku i nacionalizmit shqiptar" për krijimin e "Shqipërisë së Madhe" e kanë edhe nacionalshovinistët dhe racistët serbë, si akademiku Dobrica Qosiq, i cili e sheh "Albanizimin e hapësirave kombëtare dhe shtetërore serbe dhe jugosllave për krijimin sistematik dhe EVOLUTIV të "Shqipërisë së Madhe".

Albanizimi i hapësirave ballkanike është shpjeguar dhe përcaktuar (nga të gjitha nacionalizmat e kombeve dhe të shteteve greko-sllavoortodokse) si pushtim i tokave serbe, greke, malazeze, sllavomaqedonase e bullgare - mu atyre tokave shqiptare mijëvjeçare të pushtuara dhe të okupuara nga këta shtete fqinj me bekimin dhe ndihmën e gjithanshme të Rusisë, Francës, Britanisë së Madhe dhe të Italisë.

Ë gjithë kjo harangë e shfrenuar dhe e sofistikuar kundër "nacionalizmit" shqiptar duhej të shërbejë si katalizator kundër rishqyrtimit të gjendjes faktike të shtrirjes së popullatës shqiptare në shtetet fqinj dhe si mënyrë e metodë të eliminimit të pasojave nga kjo shtrirje, sikurse edhe për ta mbuluar dhe kamufluar nacionalizmin ekstrem ekspansionist greko-sllav në mbrojtëje të fryteve të fituara me copëtimin dhe pushtimin e trojeve mijëvjeçare shqiptare në të kaluarën e historisë së padrejtsisë nga shtetet e "qytetëruara" fqinj greko-sllavë. Me një fjalë - për spastrimin etnik të këtyre trojeve shqiptare nga elementi vetë shqiptarë, nga tokat e veta stërgjyshore.

Padrejtsitë historike kanë ekzistuar, ekzistojnë dhe do të ekzistojnë derisa të ekzistojë edhe vetë planeti ynë, por padrejtsistë ndaj kombit

dhe shtetit shqiptar janë të pakrahueshme, kundër çdo arsyeje, çdo parimi dhe çdo mendje normale.

Ideja si ide dhe dëshirë e kombit shqiptar për "Shqipërinë Etnike", për "Shqipërinë natyrore" dhe për bashkimin e kombit dhe të trojeve homogjene mijëvjeçare shqiptare: gjeografikisht, historikisht, gjeopolitikisht dhe demografikisht, por jo të "Shqipërisë së Madhe", ka ekzistuar dhe do të ekzistojë derisa të ekzistojë edhe kombi shqiptar. Mirëpo, sa është dhe a është i mundur sendërtimi i kësaj ideje-dëshirë të popullit shqiptar në këto kohra të integrimit global planetar, e të mos flasim për integrimin evropian, kur te faktorët vendosës dhe bashkësisë ndërkombëtare mbisundon ideja dhe preokupimi i zgjidhjes së problemeve ndërkombëtare dhe ndërshetërore me dialog, mirëkuptim dhe marrëveshje të ndërsjelltë; ideja e ruajtjes së paqes dhe të mirëqenies njerëzore; ideja e kozmopolitizmit dhe të shoqërisë së hapur; ideja e qarkullimit të lirë i njerëzve, kapitalit, shkencës, informatikës, teknikës dhe teknologjisë për të krijuar të mira të reja kulturore shpirtërore e materiale për një jetë të pasur dhe të denj? A është dhe sa është e mundur sendërtimi i kësaj ideje-dëshirë në rrethana të rrjedhave të strategjisë së interesave globale të shteteve Zota të fatit e të disfatës së shteteve të vegjël si faktor kryesor dhe vendimtar në marrëdhënie ndërkombëtare, pa dallim se sa janë këto vendime reale, të drejta dhe objektive? A është dhe sa është racionale dhe pragmatike kjo ide-dëshirë kur dihet se për ekzistimin e Aktit Final të Helsinkit dhe për Hartën e Parisit për mosndryshimin e kufijve ekzistuese të shteteve evropiane që, mjerisht (këto konventa ndërkombëtare) e mbështesin dhe e mbrojnë edhe juridikisht okupimin e trojeve të huaja nga ana e shteteve okupatore bizantino-sllavoortodokse? E mbrojnë të "drejtën" e këtyre shteteve pushtuese për t'i terrorizuar, masakruar, dëbuar me dhunë dhe asimiluar popujt e pushtuar deri te shfarosja biologjike! A është dhe sa është në favor dhe në dobi të interesave kombëtare dhe shtetërore shqiptare për të insistuar në sendërtimin e kësaj ideje-dëshirë (e sidomos me dhunë) kur dihet se Shtetet e Bashkuara Amerikane, Kanadaja dhe Shtetet e Unionit Evropian

qënderojnë vendosmërisht dhe pakompromis në ruajtjen e kufijve ekzistuese, të integritetit territorial dhe të sovranitetit të këtyre shteteve greko-sllavoortodokse, të cilët, të vetmit i kanë zgjëruar kufijtë e veta gjatë tërë kohës së ekzistimit të tyre?

Konfrontimi i dy milionë shqiptarëve të Kosovës me shtetet evropatlantike në mbrojtje të interesave jetike vetjake, por edhe të interesave të shteteve evropatlantike (me kontributin e luftës kundër sllavizimit total të Gadishullit Ballkanik), do të ishte katastrofale, vetëvrasëse dhe vetë shfarosëse për shqiptarët. Mjerisht, në këtë mënyrë, duke i mbështetur aspiratat dhe kërkesat babëzi të sllavëve në përgjithësi e të greko-sllavoortodokseve në Ballkan në veçanti për gllabërimin e tokave shqiptare dhe shfarosjen biologjike të shqiptarëve me terror e masakra në stilin e hordhive huno-tatatro-mongolo-sllave, po ndihmohet sendërtimi i idesë së Petrit të Madh - formimi i "Unionit të Shteteve Pansllaviste".

Zotëri Nicolas Gage (alias Nikë Gaga, Niko Gaxojanis) është vazhdues fanatik i politikës së trasuar albenofobe nga institucionet kishtare dhe shtetërore bizantino-sllavoortodokse dhe politikanëve si: Venizelos Eleutherios (1864-1936) aderues i flaktë i panhelenizmit, Pangallos (mjerisht me origjinë shqiptare-arvanitase), Papandreu dhe të ngjashëm, të cilët, u vërsulën dhe vërsulen me tërbim të shfrenuar dhe me tërë potencialin vetjak dhe shtetëror: diplomatik, politik, ekonomik, ushtarak dhe "shkençor" kundër kombit shqiptar si pengesë e vetme të sendërtimit të idesë së sllavizimit Ballkanit, duke qenë se është i vetmi komb (shqiptar-ilir) që nuk i përket kombeve greko-sllave në Ballkan. Prandaj edhe, në çdo mënyrë dhe me çdo kusht e metoda të përdorura, duhet eliminuar këtë komb "të mallkuar" nga sipërfaqja e dheut. Dhe do t'ia dilnin të sendërtojnë këtë qëllim makabër po të mos gërshetoheshin interesat kundërrthënëse të shteteve faktorë vendosës. Dhe, mjerisht, gjithnjë e më shumë po bindem se DE FACTO fuqia kryesore dhe absolute në Botë është RUSIA me rolin e vet që është duke e luajtur në arenën e diplomacisë ndërkombëtare me imponimin e pranimi të kërkesave të saja në aprovimin e konventave ndërkombëtare nën diktatin e vrazhdë të saj, duke i detyruar të gjithë

"Faktorët" të tjerë në kapitulum para shantazheve dhe kompleteve të diplomacisë së shkollës bizantino-sllave.

Formimi i shteteve etnike në Ballkan është krjetësisht i natyrshëm dhe normal për Greqinë, Serbinë, Bullgarinë, Rumaninë, Sllavomaqedonin e Malin e Zi, sikurse edhe për të gjithë shtetet e Evropës, por është në pyetje Shqipëria dhe shqiptarët - e kjo është e papranueshme dhe e palejueshme sepse e prish "konceptin e aprovuar" të shteteve të Mëdha, shteteve Faktorë vendosës dhe Zota të fateve dhe të disfateve të shteteve të vegjël.

Pse nuk ekziston dhe nuk mund të ekzistojë rreziku nga "nacionalizmi shqiptar" në Ballkan për destabilizimin e rajonit e sidomos "nacionalizmi shqiptar kosovar"? ("Nacionalizmi shqiptar" nga Shqipëria nuk paraqet kurrfarë rreziku dhe nuk vë në shprehje sepse është defaktorizuar si fuqi politike, ushtarake, ekonomike, diplomatike dhe shtetërore në Ballkan dhe është shndërruar në një LAKEJ dhe VASAL servil i gërditshëm i Greqisë pa dinjitet, pa krenari dhe pa ideal dhe ide të politikës kombëtare).

Të cilët janë faktorët vendimtar që e demantojnë absolutisht sintagmat gogolë të z. Gage-it të cituara? Çka ndikon që shqiptarët në përgjithësi e ata të Kosovës në veçanti të jenë kooperativ, realist, të urtë, të matur, pragmatist dhe të ndërgjegjshëm në drejtimin, në kohën dhe në krijimin e politikës së të mundshme e jo të politikës së dëshiruar?

1. Trendi i zhvillimit të politikës konjunkturale të Faktorëve kyç dhe vendosës: Shteteve të Bashkuara Amerikane, Kanadasë, Japonisë, shteteve të Unionit Evropian dhe të Bashkësisë ndërkombëtare për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve dhe të problemeve ekzistuese ndëretnike dhe ndërshtetërore me dialog, mirëkuptim e marrëveshje të ndërsjellta; me kooperativitet e tolerancë dhe kundër përdorimit të forcës brutale, të dhunës e terrorit ekstremist;

2. Konventat ekzistuese të shteteve evropiane, të konfirmuara dhe të nënshkruara edhe nga ana e SHBA-ve dhe Kanadasë për mosndryshimin e kufijve ekzistuese të shteteve evropiane:

a. Akti Final i Helsinkit dhe

b. Harta e Parisit

konventa këto, pa mëdyshje, që u konvenon vetëm e vetëm shteteve greko-sllavoortodokse.

3. Mungesa e potencialit vetjak shqiptar: ushtarak, njerëzor, ekonomik, industrial, hapësinor, tekniko-teknologjik dhe më e rëndësishmja - mungesa e përkrahjes së drejtave legjitime kombëtare shqiptare nga ana e Faktorëve relevantë botëror në ballafaqim të konfrontimit me shtetet greko-sllavoortodokse për të drejtat e pakontestueshme të shqiptarëve dhe të përkrahjes së STATUS QUO-së që iu përshitetet këtyre shteteve greko-sllavoortodokse;

4. Absurditeti, edhe vetëm të menduarit, i konfrontimit të dy milionë shqiptarëve të Kosovës me strategjinë e interesave globale të shteteve Faktorë relevant dhe venosës për krijimin e një bote të paqes dhe të mirëqenies pa gjakderdhje e katastrofa humanitare.

Të gjitha këto janë adute, fakte dhe argumente kokëforta dhe bindëse për shqiptarët e Kosovës, për mosndërmarrjen e aksioneve të dhunës dhe të luftës që t'i sendërtojnë sintagmat e cituara të z. Gage-it. Prandaj, shqiptarëve në Ballkan edhe u konvenon, shumë më shumë, integrimi në Evropë me proceset e zhvillimit EVOLUTIV, sesa me verpime revolucioanre, me dhunë e luftë.

Këtu edhe qëndron tentimi këmbëngulës i pushtetarëve, politikanëve, diplomatëve, analistëve dhe publicistëve të shteteve greko-sllavoortodokse që, me tërë potencialin e tyre diplomatik e propagandistik, ta udhëzojnë dhe ta orientojnë kahjen e politikës shqiptare në KONFLIKTE në Ballkan me qëllim të caktuar djallëzor për t'i diskredituar, kompromituar dhe diskualifikuar para opinionit botëror, para Faktorëve relevant dhe Bashkësisë ndërkombëtare si element destabilizuesë dhe "rrezik" potencial për rajonin. Por, NUK DO T'IA DALIN!

20 qershor 2001  
Prishtinë

Rexhep Bunjaku

